

VENDIM
Nr. 114, datë 27.3.2023

**MBI MIRATIMIN E ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË “OPERATORIT TË
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” (OSSH) SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 72 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “f”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.2 dhe pikës 2 të Programit të Pajtueshmërisë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 250, datë 21.12.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 1014/1 prot., datë 24.3.2023, “Mbi miratimin e Zyrtares të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 343, datë 21.12.2022, vendosi të miratojë Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtares të Pajtueshmërisë (ZP) të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a., duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijeni e këtij vendimi të përcjellë për miratim në ERE Zyrtares të Pajtueshmërisë, pas miratimit nga organet drejtuese të saj, e po ashtu të dokumentojë në ERE plotësimin nga Zyrtares i Pajtueshmërisë të kritereve të përcaktuara në shtojcën 1 të kontratës.

- ERE njoftoi shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e mësipërm me shkresën e ERE-s nr. 132 prot., datë 16.1.2023, ndërsa me shkresën nr. 132/2 prot., datë 15.2.2023, kujtoi shoqërinë për depozitimin brenda afatit sa përcaktuar në këtë vendim.

- Me shkresën nr. 397/2 prot., datë 28.2.2023, protokolluar në ERE me nr. 1014 prot., datë 7.3.2023, shoqëria OSSH sh.a. ka depozituar dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kështu kushtet e vendosura në pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit nr. 343/2022.

- *Zyrtares i Pajtueshmërisë, i miratuar nga organet drejtuese të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., rezultoi të jetë z. Ervis Hazizi.*

- *Shoqëria ka depozituar në ERE dhe kontratën e nënshkruar mes ZP-së të përzgjedhur, z. Hazizi, dhe OSSH sh.a. Në pikën D të kontratës përkatëse është parashikuar që të vendoset dhe vendimi i Bordit të ERE-s me të cilin miratohet Zyrtares. Në këto rrethana, vlerësohet që të përcaktohet se efektet e kësaj kontrate do të fillojnë me hyrjen në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s për miratimin e Zyrtares të Pajtueshmërisë.*

- Në shtojcën 1 të Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtares të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., miratuar me vendimin nr. 343/2022 janë listuar kriteret që duhet të përmbushë Zyrtares i Pajtueshmërisë të tillë si arsimimi, eksperiencia në profesion dhe në sektorin e energjisë elektrike.

- *Zyrtares i Pajtueshmërisë z. Ervis Hazizi, i propozuar nga shoqëria OSSH sh.a., i ka përmbushur kriteret e sipërcituara. Në pikat 1.2 dhe 2 të Programit të Pajtueshmërisë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2020, parashikohet se OSSH sh.a., përcakton, Zyrtares të Pajtueshmërisë, i cili më pas miratohet me vendim të Bordit të ERE-s për një mandat 3-vjeçar (trevjeçar).*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë emërimin e z. *Ervis Hazizi* si Zyrtar i Pajtueshmërisë të “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për një mandat 3-(tre)-vjeçar.

2. Efektet e kontratës së nënshkruar mes shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe z. *Hazizi* fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti